



REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI I QARKUT FIER
KOMITETI RAJONAL ANTITRAFIKIM

Nr. 267 Prot.

Fier, më 09.03.2023

URDHËR

Nr. 12, datë 09.03 2023

PËR

NGRITJEN E KOMITETIT RAJONAL TË LUFTËS KUNDËR
TRAFIKIMIT TË PERSONAVE, TË QARKUT FIER

Mbështetur në nenin 20 pika 1 të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, dhe në zbatim të Urdhrit Nr.6 datë 27.01.2017 “Për Krijimin e Komiteteve Rajonale të Luftës Kundër Trafikimit të Personave në çdo Qark” të Kryeministrit ;

U R D H Ë R O J:

1.Krijimin e Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave të Qarkut Fier me përbërje si më poshtë vijon :

- | | |
|--|-----------|
| 1. Prefekti i Qarkut Fier | Kryetar |
| 2. Kryetari i Këshillit të Qarkut Fier | N/Kryetar |
| 3. Kryetari i Bashkisë Fier | Anëtar |
| 4. Kryetari i Bashkisë Lushnje | Anëtar |
| 5. Kryetari i Bashkisë Mallakastër | Anëtar |
| 6. Kryetari i Bashkisë Patos | Anëtar |
| 7. Kryetari i Bashkisë Roskovec | Anëtar |

8. Kryetari i Bashkisë Divjakë	Anëtar
9. Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë	Anëtar
10. Drejtori Rajonal i SHISH-it Fier	Anëtar
11. Drejtori i Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Vlorë	Anëtar
12. Drejtori Rajonal i Shërbimit Social Shtetëror Fier	Anëtar
13. Drejtori Rajonal i Punësimit Fier	Anëtar
14. Drejtori i Inspektoratit Shtetëror të Punës Fier	Anëtar
15. Drejtori i Drejtorisë së Formimit Profesional Fier	Anëtar
16. Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier	Anëtar
17. Drejtori i Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Fier	Anëtar

Sipas listës së bashkëngjitur këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Komiteti Rajonal i Luftës kundër Trafikimit të Personave të qarkut Fier, është përgjegjës për:
 - Identifikimin e problemeve parësore në nivel qarku, në përputhje me Strategjinë e Luftës kundër Trafikimit të Personave ;
 - Miratimin e rregullores së funksionimit të këtij komiteti, sipas formatit tip të lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet urdhrit të Kryeministrit (të sipërcituar) dhe është pjesë përbërëse e tij;
 - Hartimin dhe miratimin e planit të veprimit të qarkut Fier, për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave, i cili të harmonizohet me planin e veprimit të Strategjisë së Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe të konsultohet paraprakisht me zëvendësministrin e Punëve të Brendshme / Koordinatorin Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit të Personave;
 - Marrjen e masave për mbrojtjen e individëve dhe grupeve të rrezikuara nga trafikimi, në mënyrë të veçantë të grave dhe fëmijëve, duke krijuar një bazë të dhënash për të gjitha kategoritë dhe individët e rrezikuar nga trafikimi;
 - Ngritjen e Tryezës Teknike (TT) të qarkut Fier dhe Nen komiteteve Rajonale të Luftës kundër Trafikimit të Personave në nënprefekturën e Lushnjës dhe Mallakastrës të kryesuar nga nënprefektët respektiv, që kanë të njëjtën përbërje, mënyre raportimi dhe përgjegjësi.

3. Komiteti Rajonal i Luftës kundër Trafikimit të Personave të qarkut Fier të mbledhet njëherë në 3 (tre) muaj, ose në raste të veçanta, më shpesh, me kërkesën e kryetarit ose çdo anëtarit të tij, duke njoftuar paraprakisht Koordinatorin Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit të Personave.

4. Komiteti Rajonal i Luftës kundër Trafikimit të Personave të qarkut Fier ka këto detyra :
 - Të organizojë veprimtarinë e komitetit, bazuar në Strategjinë e Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe të ndajë përgjegjësitë institucionale dhe zbatimin e prioriteteve antitrafik;
 - Të raportojë tek zëvendësministri i Punëve të Brendshme / Koordinatori Kombëtar për Çështjet e Luftës kundër Trafikimit të Personave, për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër

Trafikimit të Personave dhe të plan veprimet rajonal të komitetit, si dhe për masat e aktivitetet parandaluese antitrafik në qarkun Fier, njëherë në tre muaj, sipas formatit tip të lidhjes nr.2 që i bashkëlidhet urdhrin të kryeministrit dhe është pjesë përbërëse tij.

- Caktohet z. Hekuran Resulaj (me detyre funksionale Specialist i Sektorit të Kompetencave Vendore, në Institucionin e Prefektit të qarkut Fier), të shërbejë si sekretariat teknik i Komitetit Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të Personave të qarkut Fier, për sigurimin, mbështetjen administrative dhe logjistike të veprimitarisë së këtij komiteti.

5. Sekretariati Teknik ka këto detyra :

- Të mbajë kontakte me të gjithë Anëtarët Komitetit Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të Personave , Tryezës Teknike (TT) dhe nen komiteteve në funksion të tij.
- Të njoftojë për takimet Anëtarët e Komitetit Rajonal të Luftës kundër Trafikimit Personave të qarkut Fier, si dhe të sigurojë grumbullimin dhe shkëmbimin e materialeve për takimet e planifikuara.
- Të sigurojë mbledhjen dhe shkëmbimin e të dhënave në nivel qarku për detyrat antitrafik, si dhe të administrojë ato raste konkrete të trajtuara në Tryezën Teknike rajonale.
- Të hartojë raportet tremujore të zbatimit të planit të veprimet të komitetit.

6. Anëtarët e Komitetit Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të Personave të caktojnë persona teknikë nga sektorët përkatës të tyre për të formuar Tryezën Teknike, e cila kryesohet nga Koordinatorin Përgjithshëm i institucionit të Prefektit të qarkut Fier dhe të ketë përbërje si më poshtë;

- Një përfaqësues nga Këshilli i Qarkut Fier;
- Një përfaqësues nga secila bashki/Drejtoria e Shërbimeve dhe Kujdesit Shoqëror të saj;
- Një përfaqësues nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) dhe Njësia e Dhunës në Familje dhe Barazisë Gjinore nga bashkitë që kanë krijuar një strukturë të tillë;
- Shefi i Seksionit për Trafiqet e Paligjshme në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier;
- Një Përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit për Fierin;
- Një përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror Fier;
- Një përfaqësues nga Drejtoria Rajonale Punësimit Fier;
- Një përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Informativ Shtetëror Fier;
- Një përfaqësues nga Drejtoria Arsimore Rajonale Fier;
- Nga një përfaqësues për çdo Drejtori të Shëndetësisë, Fier, Lushnje dhe Mallakastër;
- Një përfaqësues nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore Fier;
- Një përfaqësues nga Drejtoria e Formimit Profesional Fier;
- Përfaqësues nga OJF-të dhe shoqëria civile;

Të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Tryezës Teknike (TT), përfaqësues të prokurorisë së rrethit gjyqësor Fier.

7. Tryeza Teknike e qarkut Fier për çështjet e luftës kundër trafikimit të personave të mbledhet një herë në 2 (dy) muaj dhe ka këto detyra :

- Të identifikojë problemet parësore në fushën e luftës kundër trafikimit të personave;
- Të mbledhë dhe shkëmbej të dhëna mbi identifikimin fillestar, referimin dhe zgjidhjen e rasteve konkrete;
- Të përcaktojë veprimet e nevojshme për parandalimin e trafikimit dhe mbrojtjen e familjeve, grupeve, personave dhe fëmijëve në rrezik aktual ose potencial trafikimi;
- Të mbikëqyrin zbatimin e detyrave vendore antitrafik, në përputhje me detyrat e veçanta të çdo institucioni të përfaqësuar në këtë komitet;

8. Tryeza Teknike (TT) të raportojë me shkrim te Komiteti Rajonal i Luftës kundër Trafikimit të Personave të qarkut Fier, mbi ecurinë e rasteve të trajtuara, pas çdo mbledhjeje.

9. Ngarkohen me përgjegjësi për përmbushjen e detyrave në zbatim të këtij urdhri, institucionet dhe bashkitë e qarkut tonë, që përfshihen në përbërje të Komitetit Rajonal i Luftës kundër Trafikimit të Personave.

10. Urdhri nr.15 datë 23.03.2022 i Prefektit të Qarkut për ngritjen e Komitetit Rajonal të luftës kundër trafikimit të personave”, shfuqizohet

11. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PREFEKTI

Lefter SHEHAJ





REPUBLIKA E SHQIPERISË
PREFEKTI QARKU FIER

KOMITETIT RAJONAL TE LUFTES KUNDER TRAFIKIMIT TE PERSONAVE, QARKU FIER

LISTA E KONTAKT-KOMUNIKIMEVE ME DREJTUESIT E INSTITUCIONEVE/BASHKIVE, TE QARKUT FIER
ANETARE TE KOMITETIT RAJONAL TE LUFTES KUNDER TRAFIKIMIT TE PERSONAVE

Rifreskuar 05.03.2023

NR.	FUNKSIONI INSTITUCIONAL	EMER MBIEMER	FUNKSIONI	Telefon	E-MAIL	Emaili I Istitucionit
1	PREFEKTI I QARKUT FIER	Lefter Shehaj	PREFEKT	0685557859	Lefter.Shehaj@mb.gov.al	Prefekti.Fier@mb.gov.al
2	KRYETARI I KESHILLIT TE QARKUT FIER	Evis Sema	N/KRYETAR	0696289441	evi_sema@yahoo.com	keshilliqarkutfier@gmail.com
3	KRYETAR I BASHKISE FIER	Armando Subashi	ANETAR	0697001199	armando.subashi@bashkiafier.gov.al	info@bashkiafier.gov.al
4	KRYETAR I BASHKISE LUSHNJE	Eriselda Sefa	ANETAR	0696271784	eriseldasefa@hotmail.com	bashkia_lushnje@yahoo.com
5	KRYETAR I BASHKISE MALLAKASTER	Qerim Ismailaj	ANETAR	0695742626	qerimismailaj@bashkiamallakaster.gov.al	ballshi@bashkiamallakaster.gov.al
6	KRYETAR I BASHKISE PATOS	Rajmonda Balilaj	ANETAR	0693200423	rajmondabalili@yahoo.com	info@bashkiapatos.gov.al
7	KRYETAR I BASHKISE ROSKOVEC	Majlinda Bufi	ANETAR	0692064407	majlindabufi@gmail.com	info@bashkiaroskovec.gov.al
8	KRYETAR I BASHKISE DIVJAKE	Fredi Kokoneshi	ANETAR	0682008828	fredikokoneshi@yahoo.com	info@bashkiadivjake.gov.al
9	DREJTOR I DREJTORISE POLICISE VENDORE	Lorenc Panganika	ANETAR	0694102225	lorenc.panganika@asp.gov.al	sallaoperativefier@asp.gov.al
10	DREJTORI RAJONAL I SHISH--it FIER	Sokol Jahollari	ANETAR	0697032606	jahollarisokol@gmail.com	Nuk ka
11	DREJTORI RAJONAL I SHSSH--it FIER	Albert Sema	ANETAR	0682251080	albert.sema@sociale.gov.al	Nuk ka
12	Drejt.Rajon.Agjencis.Punesim.Fier	Edlira Doko	ANETAR	0694233011	edlira.doko@akpa.gov.al	drshkpfier@yahoo.com
13	DREJTORI DRAP - it FIER	Flutura Meçaj	ANETAR	0676886969	Flutura.Mecaj@arsimi.gov.al	darfier@arsimi.gov.al
14	DREJTORIA E SHENDETIT PUBLIK FIER	ARBER ARAPI	ANETAR	0693169297	arber86_86@live.com	NJVKSHFier@shendetesia.gov.al
15	DREJTORIS I FORMIMIT PROFESIONAL FIER	Ermelinda Kuko	ANETAR	0696165400	ermelindagishto@yahoo.com	qfpp@yahoo.com
16	DREJTOR I INS. SH. TE PUNES FIER	Harilla Jano	ANETAR	0696618131	harillajano@yahoo.com	Kuk ka
17	DVKM Vlorë	Eduard Sulejmani	ANETAR	694105035	eduard.sulejmani@asp.gov.al	DRKMVlorë@asp.gov.al